

URDHËR
Nr. 414, datë 26.7.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 313, DATË 20.10.2020, TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE PROCEDURAT E EMËRIMIT, PEZULLIMIT DHE LARGIMIT NË SHËRBIMIN PSIKOSOCIAL", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 20 dhe të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

a) Shkronja "a", e pikës 3, të kreut III ndryshohet, si vijon:

"a) "Psikologu duhet të ketë diplomë të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, ose ekuivalente me to në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015, dhe pas vitit 2019, licencë në fushën e psikologjisë së edukimit të lëshuar nga Urdhri i Psikologut".

b) Pika 7, e kreut IV, ndryshohet si vijon:

"7. Për realizimin procedurave të konkurrencës dhe të shpalljes së listës të kandidatëve fitues, DRAP-i përkatës krijon një komision ad-hoc, i cili përbëhet nga 2 (dy) përfaqësues nga MAS-i, nga 1 (një) përfaqësues nga DPAP-ja, 1 (një) përfaqësues nga njëra prej ZVAP-ve, 1 (një) përfaqësues nga DRAP-i".

c) Pas kreut IV, shtohet kreu IV/1, me përmbajtje:

"KREU IV/1

1. Në përfundim të vitit shkollor procedurat e lëvizjes paralele administrohen nga DRAP-ja, për punonjësit e SHPS që ushtrjnë profesionin në institucionet arsimore publike parauniversitare, brenda juridiksionit të zyrave vendore të arsimit parauniversitar.

2. Punonjësi i SHPS që dëshiron të kryejë lëvizje paralele në përfundim të vitit shkollor, dërgon me postë në DRAP kërkesën për lëvizje paralele.

3. Dorëzimi i dosjeve për lëvizje paralele bëhet sipas afateve të përcaktuara nga DPAP-ja.

4. DRAP-ja krijon komisionin e vlerësimit të dosjeve për lëvizje paralele, me këtë përbërje:

a) drejtuesi i DRAP-së (kryetar);

b) një specialist i kurrikulës dhe zhvillimit profesional në DRAP (anëtar);

c) juristi i DRAP-së (anëtar).

5. Komisioni i vlerësimit të dosjeve në DRAP bën vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për lëvizje paralele sipas shtojcës nr. 2 të urdhrit, brenda muajit korrik.

6. Komisioni i vlerësimit të dosjeve shpall renditjen e konkurrentëve për lëvizje paralele sipas zyrave vendore dhe pikëve në rendin zbritës. Lista me renditjen e punonjësve të SHPS-së shpallet në faqen elektronike zyrtare të DRAP-së, e cila dërgon një kopje të listës në DPAP.

7. Punonjësi i renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës brenda ZVAP-së ku ka emërimin e përhershëm. Ai dërgon brenda 24 orëve me e-mail konfirmimin ose refuzimin e vendit të propozuar. Në rast të mos konfirmimit nga kandidati, ky vend pune i ofrohet punonjësit të listuar një rend më poshtë.

8. Pas përzgjedhjes së vendit të punës nga kandidati, DRAP-i përkatës nxjerr aktin e emërimit të kandidatit në institucionin arsimor parauniversitar të përzgjedhur prej tij dhe nënshkruan kontratën e punës me të".

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të

arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi